

- Dokumentacion, statistika dhe sisteme - Standardet II.13 / II.14 / V.4
- Informim publik - Standardi I.6

7. **Menaxhimi i marrëdhënieve.** FGJH njeh rëndësinë e palëve të interesuara (studentë, staf akademik dhe administrativ, punëdhënës, institucione partnere, komuniteti dhe shoqëria në tërësi) në ndikimin që ato kanë mbi performancën institucionale.

Menaxhimi efektiv i marrëdhënieve me këto palë synon ndërtimin e bashkëpunimeve të qëndrueshme dhe optimizimin e ndikimit të tyre në zhvillimin e institucionit. Suksesi afatgjatë arrihet përmes dialogut të vazhdueshëm, bashkëpunimit dhe integritetit të pritshmërive të palëve të interesuara në proceset e sigurimit të cilësisë.

➤ **Indikatorë matës (KPI)**

- Numri i marrëveshjeve aktive me partnerë
- Pjesëmarrja e punëdhënësve në rishikimin e programeve
- Feedback-u i palëve të interesuara (anketa, takime)
- Aktivitetet e përbashkëta me komunitetin dhe biznesin

➤ **Në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe legjislacionin e ASCAL**

- Bashkëpunime dhe partneritete - Standardet II.19–II.21 / II.20 / II.22
- Alumni - Standardi V.9

D. Fushat e veprimtarive në kuadër të sigurimit të cilësisë

Sigurimi i brendshëm i cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja mbështetet në Rregulloren e Cilësisë së UT-së, Statutin e institucionit dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Ky proces përqendrohet në vlerësimin sistematik, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë akademike dhe administrative. Fushat kryesore të veprimtarisë në kuadër të sigurimit të cilësisë janë si më poshtë:

1. Veprimtaria tërësore e institucionit

Kjo fushë përfshin vlerësimin e funksionimit të përgjithshëm të fakultetit në përputhje me misionin, vizionin dhe objektivat strategjike të institucionit. Analizohet efektiviteti i strukturave drejtuese, zbatimi i politikave të brendshme, transparenca në vendimmarrje dhe koherenca midis strategjisë institucionale dhe praktikave të përditshme.

2. Programet e studimit dhe procesi i mësimdhënies

Në këtë fushë vlerësohet cilësia e programeve të studimit, përmbajtja e kurrikulave, rezultatet e të nxënësve dhe përputhja e tyre me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu monitorohet procesi i mësimdhënies, përdorimi i metodologjive bashkëkohore, ngarkesa akademike dhe efektiviteti i metodave të vlerësimit të studentëve.

3. Kërkimi shkencor dhe veprimtaria kërkimore





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**



Strategjia për Mësimdhënien në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja

2026 - 2028

**Miratuar me Vendim Dekanati
Nr. 08 Datë 02.03 2026**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Strategjia për Mësimdhënien në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja

Plani strategjik për mësimdhënien në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e Universitetit të Tiranës, Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës, Strategjinë e zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja si dhe Strategjinë Institucionale për Mësimdhënien në UT në të cilën përcaktohen parimet, objektivat dhe strategjitë e zbatimit në fushën e mësimdhënies që duhet ndjekur në mënyrë që UT-ja dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja të përballojnë sfidat aktuale dhe ato të së ardhmes. Plani përcakton vizionin, qëllimet, objektivat strategjike dhe veprimtaritë përkatëse në lidhje me mësimdhënien në Fakultet për vitet akademike 2026-2028.

VIZIONI

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja synon të përgatitë specialistë dhe profesionistë, të cilët i përgjigjen kërkesave të tregut dhe njëkohësisht ndihmojnë në zhvillimin e vendit në integrimin evropian, që përmes mësimi, shërbimit dhe kërkimit të kontribuojnë në formimin cilësor të studentëve, në përmbushjen personale të tyre, në krijimin e mirëkuptimit të ndërsjelltë, të harmonisë shoqërore dhe ndjenjës së qytetarisë globale të shekullit XXI, të shërbejë si urë komunikimi për çështjet me interes kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, duke krijuar një hapje dhe ndjeshmëri ndaj kulturave të ndryshme në fushën e gjuhëve, letërsisë dhe komunikimit.

Veprimtaria e Fakultetit organizohet në tre drejtime kryesore: mësimdhënie, kërkim shkencor dhe shërbim ndaj të tretëve, të cilat ndërveprojnë ngushtë midis tyre. Ndërveprimi i gjithë burimeve njerëzore, përdorimi efektiv i infrastrukturës dhe aseteve në dispozicion do të mundësojnë një performancë më të lartë dhe përmbushjen e objektivave të Fakultetit. Kompetenca profesionale e stafit si dhe zbatimi i politikave më të efektshme të menaxhimit janë faktorë që sigurojnë arritjen e qëllimeve strategjike.

Zhvillimi i mëtejshëm institucional i Fakultetit, rritja e rëndësisë së tij në tregun e brendshëm dhe ndërkombëtarizimi varen drejtpërdrejt nga cilësia e programeve të ofruara dhe zbatimin e tyre me efektivitet.

Arritja e objektivave mundësohet nëpërmjet:

- përmirësimit të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, operativ dhe efikas;





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- mbikëqyrjes së vazhdueshme të mbarëvajtjes së programeve mësimore në të tre ciklet e studimit;
- ofrimit të programeve të reja ose rishikimit të programeve aktuale në përputhje me nevojat e tregut të punës;
- mbikëqyrjes dhe vlerësimit të performancës së stafit;
- mbështetjes dhe nxitjes së zhvillimit profesional të vazhdueshëm të stafit;

ofrimit të një mësimdhënie efektive që nxit të nxënësit aktiv dhe zhvillimin e të menduarit kritik të studentëve:

- lidhjes së mësimdhënies me praktikën dhe tregun e punës;
- përmirësimit të vazhdueshëm të vlerësimit të studentëve të mbështetur në kompetenca;
- përfshirjes së studentëve në vlerësim dhe në vendimarrje.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

OBJEKTIVAT SIPAS PLANIT STRATEGJIK TË UT-së

Objekti 1. Krijimi i mundësive për të gjithë studentët për të zhvilluar potencialin e tyre duke ofruar një mjedis jo vetëm mbështetës, por edhe stimulues.

Objekti 2. Lidhja e programeve të studimit me tregun e punës.

Objekti 3. Zhvillimi i kurrikulave, rezultateve të të nxënës, vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë që marrin në konsideratë aftësitë e nevojshme për sfidat aktuale dhe të ardhshme të shoqërisë.

Objekti 4. Kërkimi i formave për të zbatuar metoda të reja dhe inovative të mësimdhënies ndërdisiplinare me në qendër studentin, me fokus tek qasjet ndër- dhe shumëdisiplinare, mësimdhënien dhe të nxënës e bazuar tek kërkimi shkencor.

Objekti 5. Promovimi i formimit të vazhduar për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.

Objekti 6. Lidhja e universitetit me shoqërinë, forcimi i dimensionit social të universitetit.

Plani i veprimit sipas fushave strategjike	Veprimtaritë	Treguesit	Afati	Personi përgjegjës
Objekti 1 — Përvoja dhe suksesi i studentit (orientim, mbështetje, përfshirje)				
Orientim i studentëve të vitit të parë dhe asistencë	Javë informuese; kalendar takimesh; Leksione të hapura për shëndetin mendor; Sondazh për pritshmëritë; Ofrim i asistencës psikologjike	Nr. i studentëve të vitit I; më shumë se 2 leksione/vit; koha mesatare e pritjes për këshillim deri në 5 ditë; norma e përgjigjeve në	Çdo fillim viti akademik; vjetore	Zyra e Këshillimit të Karrierës; Këshilli Studentor; NJSBC; Psikologu; Departamentet





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

		sondazh më shumë se 50%		
Mbështetje akademike/administrative dhe aksesueshmëria	Përmirësimi i komunikimit digjital; Aktivitete të bibliotekës; Mësim online dhe tutorim; Materiale të përshtatura për studentët me aftësi ndryshe	më shumë se 95% e njoftimeve publikohen në kanalet zyrtare të fakultetit brenda 24 orëve; më shumë se 4 aktivitete promovuese të librit/vit; më shumë se 1 paketë materialesh e aksesueshme për programin	Gjatë viteve 2026–2028	Sekretaret e departamenteve; Zyra IT; Biblioteka FGJH; Dekanati; Administratori
Veprimtari ekstrakurrikulare dhe klube	Organizim kalendari vjetor; Klube studentore; Evente kulturore dhe akademike; Publikime në WEB/rnjete	Nr. i aktivitete për semestër; Nr. i pjesëmarrjes së studentëve; Nr. i publikimeve publikim në WEB për aktivitet	Çdo vit akademik (kalendari vjetor)	Koordinatorët e klubeve; Njësitë bazë; Këshilli Studentor; Zyra e Karrierës
Vlerësimi dhe njohja e arritjeve	Çmime morale dhe materiale: për studentët ekselentë, për tezën më të mirë, për kontribut kulturor	më shumë se 3 çmime/vit; raportim publik në faqen zyrtare	Gjatë vitit akademik	Dekanati; Departamentet ; Këshilli Studentor; Administratori





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Zëri i studentit dhe feedback i strukturuar	Pyetësorë semestralë për mësimdhënien, infrastrukturën dhe shërbimet	Norma e përgjigjeve më shumë se 50% në semestër; plan përmirësimi i publikuar brenda 30 ditëve nga mbyllja e sondazhit	Çdo semestër	NJSBC; Zyra e Karrierës; Departamentet
Objektivi 2 — Kurrikula, pedagogjia dhe digjitalizimi (LO, vlerësimi, teknologjia)				
Përmirësimi i mësimdhënies dhe i rezultateve të të nxënit	Zbatim metodash aktive në mësimdhënie; Përditësim i syllabuseve në bazë kompetencash/rezultatesh; Ndarje praktikash të mira	Syllabuset 100% të përditësuara	2026–2028 (vjetore)	Dekanati; Departamentet
Mësim i bazuar në kërkim dhe aftësi të të nxënit	Workshope për studentët mbi study skills; aktivitete kërkimore të integruara në lëndë	Nr. i aktiviteteve për semestër; sondazh vjetor mbi perceptimet e studentëve dhe stafit	Semestra I; vjetor	Departamentet ; Zyra e Karrierës; Qendra e Trajnimeve; NJSBC
Trajnime për stafin akademik	Trajnime periodike për mësimdhënie dhe mësimnxënie; Leksione të hapura	më shumë se 2 trajnime/semestër; më shumë se 70% e stafit merr pjesë çdo vit	2026–2028	Dekanati; UT; Departamentet
Programe modulare dhe mikro-kredenciale	Dizajnim dhe miratim i mikro-kredencialeve ndërdisiplinore	më shumë se 1 mikro-kredencial për Departament deri në dhjetor 2027	2026–2027	Qendra/ Zyra e Trajnimeve; Departamentet





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Hartëzimi i rezultateve të të nxënës dhe vlerësimi	Publikimi i kriterëve të vlerësimit për çdo lëndë; mekanizma monitorimi (pyetësorë, vetëvlerësim)	100% e lëndëve me kriterë të publikuara brenda javës së parë; Raporte monitorimi 2x/vit	Tetori i çdo viti; dhjetor-janar & maj-qershor	Grupet mësimore; NJSBC; Zyra e Karrierës
Përdorimi i teknologjive digjitale & hapësira coworking	Sigurimi i funksionimit të pajisjeve; trajnime për integrimin e TIK; zhvillimi i hapësirës Open Space/Coworking	më shumë se 80% e auditorëve të pajisur funksionalisht; më shumë se 3 trajnime TIK/vit; hapësira coworking funksionale	Gjatë gjithë vitit; objektive afatmesme	Zyra IT; Departamentet ; Dekanati
Programe të përbashkëta / të dyfishta	Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve me universitete partnere	Nr. i marrëveshjeve /programeve të reja/vit	Vjetor	Departamentet ; Dekanati
Objektivi 3 — Punësueshmëria, praktikat dhe partneritetet me tregun e punës				
Përditësim kurrikulash sipas nevojave të tregut	Riorganizim programesh; hapje programësh të rinj; shtim i praktikave mësimore; takime periodike me ALUMNI	më shumë se 1 rishikim/program/vit; më shumë se 2 takime ALUMNI/vit; më shumë se 70% e lëndëve profesionale me komponent praktik	Vjetor	Departamentet ; Grupet mësimore; Zyra e Cilësisë & Kurrikulës; Zyra e Karrierës
Partneritete dhe praktika profesionale	Përshtatje e raportit teori/praktikë; përditësim i bazës së të dhënave për praktikat; nënshkrim i MoU me biznese/institucione	më shumë se 10 MoU të reja 2026–2028; baza e të dhënave përditësohet çdo semestër; më shumë se 70% e studentëve	Gjatë viteve 2026–2028	Departamentet ; Zyra e Karrierës; Koordinatorët e praktikës





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

		kryejnë praktikë të dokumentuar		
Monitorim dhe vlerësim i praktikave	Relacion i shkurtër nga studentët; pyetësor; fletë vetëvlerësimi e praktikës	Raporte standarde për 100% të praktikantëve; analizë vjetore e rezultateve	Semestra I; Qershor çdo vit	Koordinatorët e praktikës; NJSBC; Departamentet
Praktika dhe mobilitete ndërkombëtare	Organizim i praktikave në universitete/organizata ndërkombëtare	më shumë se 20 studentë në praktika ndërkombëtare/vit	Vjetor	Dekanati; Zyra e Karrierës
Harmonizimi me provimin e licencimit	Leksione të hapura informuese; orientim drejt ndërdisiplinaritetit	më shumë se 1 leksion/semestër; udhëzues informues i publikuar në WEB	Fillim i çdo viti akademik ; semestral	Departamentet
Objektivi 4 — Kërkimi i lidhur me mësimdhënien dhe diseminimi				
Mësim i përqendruar tek kërkimi	Zhvillim/përdorim metodash të reja (përfshirë elektronike); balancim teori-praktikë (orë laboratorike); aktivitete promovuese dhe konferenca studentore	më shumë se 1 workshop kërkimor/muaj; përdorim i laboratorëve; konferencë studentore vjetore	Gjatë vitit; vjetor	Departamentet ; Grupe mësimore; Zyra IT; Dekanati; Këshilli Studentor
Diseminimi i rezultateve të kërkimit	Promovim i botimeve të stafit në revista shkencore; proceeding books; zhvillim i bazës online të kërkimit të	më shumë se 10 publikime në revista të indeksuara/vit; bazë e të dhënave online funksionale; raport	Vjetor; gjatë vitit	Departamentet ; Zyra e Kërkimit Shkencor





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

	FGJH; raport i vetëvlerësimit	vjetor për publikimet dhe konferencat		
Përfshirja e studentëve në kërkim	Projekte të përbashkëta pedagog–student; konferenca vjetore e FGJH me pjesëmarrje të studentëve Master; orientimi i temave të masterit drejt kërkimit dhe bashkëpunimit me biznesin	më shumë se 15% e studentëve Master bashkautorë me pedagogë deri në 2028; më shumë se 1 konferencë vjetore; bazë e të dhënave e temave të masterit e përditësuar	2026–2028; vjetor	Dekanati; Departamentet ; Këshilli Studentor
Objektivi 5 — Zhvillimi i stafit dhe mobilitetet				
Zhvillim profesional i stafit akademik dhe ndihmës	Shkëmbim metodash; tavolina të rrumbullakta; leksione të hapura; orë model; trajnime për TIK dhe metoda aktive; shkëmbime Erasmus	më shumë se 4 trajnime/semestër; pjesëmarrje më shumë se 70%; organizohet ‘Java e Teknologjisë’ 1x/vit	Gjatë viteve 2026–2028	Koordinatori për trajnime; Zyra e Informatikës; AUF (nëse e aplikueshme); Burimet Njerëzore
Mobilitete hyrëse/dalëse për staf dhe studentë	Mundësi mbështetëse pritëse/dalëse; informim i vazhdueshëm	më shumë se 30 mobilitete/vit (hyrëse + dalëse); raportim publik i statistikave	Vjetor	Dekanati; Departamentet
Objektivi 6 — Dimensioni social dhe angazhimi me komunitetin				
Komunikim publik dhe promovim	Takime me komunitetin për të prezantuar veprimtarinë mësimore–	më shumë se 15 gjimnaze të informuara/mars–maj;	Mars–Maj çdo vit; gjatë	Dekanati; Departamentet ; Zyra e





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

	kërkimore; ditë të hapura me maturantë; përditësim i WEB dhe rrjeteve sociale me materiale promovuese	fletëpalosje dhe plan takimesh vjetor; përditësim i WEB/rrjeteve më shumë se 1 herë/javë	gjithë vitit	Këshillimit të Karrierës
Përvoja sociale dhe kulturore për komunitetin	Organizimi i shkollave verore/dimërore; forume me mësuesit e sistemit parauniversitar; trajnime për mësues të gjuhëve të huaja për integrimin e teknologjisë	më shumë se 2 shkolla verore/dimërore/vit; më shumë se 3 forume me mësues/vit; plan dhe program trajnimesh të publikuar	Vjetor; gjatë vitit	Qendra e Trajnimeve; Departamentet ; Dekanati
Angazhimi vullnetar i studentëve	Pjesëmarrje në veprimtari artistike–kulturore dhe sensibilizuese në bashkësinë lokale	më shumë se 6 veprimtari vullnetare/vit; raportim dhe publikim në WEB	Gjatë vitit akademik	Klubet e Fakultetit; Departamentet

Miratoi

DEKAN

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA

